



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prade - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 55/2024

Datë: 11/03/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (GZ/Nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 3 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Ligjit Nr. 08/L-033 për Provimin e Jurisprudencës dhe në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 06/2022 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurisprudencës, si dhe Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë

V E N D I M

1. Znj. Fitore Byqmeti emërohet Sekretare e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës.
2. Obligohet e emëruara nga pika 1 e këtij vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e saj t'i kryejë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Sekretares së Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës për punën e saj i takon kompensimi sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr.105/2021, i datës 28.06.2021.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i'u dërgohet:

- *Znj. Fitore Byqmeti;*
- *Anëtarëve të Komisionit për Dhënie e Provimit të Jurisprudencës;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Departamentit për Profesione të Lira;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*